

Thu 2/29/2024

Në vijim të kërkesës Suaj, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë me Nr.468, datë 27.02.2024, "Kërkesë për informacion", Ju bëjmë me dije si më poshtë :

Drejtoria e Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) në zbatim të Ligjit nr.126, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë", Urdhërit të Ministrit të MFE-së Nr. 219, datë 21.09.2022, "Për miratimin e rregullores për verifikimin e instrumentave matëse ligjërish të kontrolluara" Aneksi 2.1, "Tabela e intervaleve të verifikimit periodik të instrumentave matës ligjërish të kontrolluar", (tabela 1, pika Nr. 6), afati i detyrueshëm për verifikimin periodik në muaj është 60 (në rastet e pikave të shpërndarjes me pakicë të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm) ndërsa kalibrimi bazuar në legjislacionin në fuqi ka vlefshmëri 10 vite (në rastet e pikave të shpërndarjes me shumicë të hidrokarbureve dhe gazit të lëngshëm).

Përsa i përket aparateve të shpërndarjes të karburanteve për automjete dhe aparate të shpërndarjes së LPG për automjete afati i detyrueshëm për verifikimin periodik në muaj është 6 (tabela 1, pika Nr. 16,17).

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,
Drejtoria e Përgjithshme të Metrologjisë